# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-447886**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Po transportonte 6 shtetas të huaj drejt Tiranës, arrestohet 23-vjeçari në Korçë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/16/po-transportonte-6-shtetas-te-huaj-drejt-tiranes-arrestohet-23-vjecari-ne-korce/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 07:33:56 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 16 shtator 2026, 07:26:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 16 shtator 2026, 07:25:00 UTC → 16 shtator 2026, 07:27:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a6781ed4ea35d118423cf9e20e2e6bea111ce6eb02994d82e02c9bcab484e012` |
| TEKSTI | `18e261e81280d986bfbeff37c05917982a9e4620c175ade79bbf7e18b1ffdaa7` |
| PAMJA | `243a52ff6e42a352a0277e2c0295c1113f84ccc0189c5180c8dd180b19100936` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ac5e4302de53d1a560885e13699ee615d4a2c2cebfe15aaf4364e67ff02991e1` |
| E MËPARSHMJA | `ac53e828a01f745dd467cbddaad0053b471fa924f5ce6742cbec0c799180b056` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ac5e4302de53d1a560885e13699ee615d4a2c2cebfe15aaf4364e67ff02991e1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET TË FUNDIT

# Po transportonte 6 shtetas të huaj drejt Tiranës, arrestohet 23-vjeçari në Korçë

16/09/2026 09:26




**Vijojnë operacionet për kapjen e personave të përfshirë në aktivitetin e paligjshëm të dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve.**

Një 23-vjeçar ka rënë në prangat e policisë gjatë një operacioni të zhvilluar mbrëmjen e djeshme në Devoll.

Operacioni është zhvilluar nga Seksioni i trafiqeve dhe Seksioni i krimit ekonomik dhe financiar në DVP Korçë, në kuadër të punës operativo-hetimore për goditjen e rasteve të ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit.

Burime nga policia bëjnë me dije se në pranga ka rënë Klajdi Muça, nga qyteti i Durrësit, i cili drejtonte një automjet tip Benz dhe gjatë kontrollit të uniformave blu, brenda mjetit janë gjetur 6 emigrantë të paligjshëm. Këta të fundit ishin shtetas sudanezë, të cilët dyshohet se po transportoheshin drejt Tiranës, me qëllim kalimin jashtë shtetit.

Sipas informacioneve, mësohet se për këtë aktivitet, 23-vjeçari dyshohet se do të përfitonte 600 deri në 700 euro për person.

Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar automjeti, një sasi lekësh dhe disa aparate celularë. Ndërkohë, vijon puna për dokumentimin e plotë të ngjarjes dhe identifikimin e personave të tjerë që mund të jenë të përfshirë.

**Njoftimi i policisë:**

DVP Korçë/Vijojnë goditjet ndaj veprimtarisë kriminale të dhënies ndihmë emigrantëve nga Vendet e Treta, për kalim të paligjshëm të kufirit, kundrejt fitimit.

Finalizohet pas 3 javësh hetime me metoda proaktive, operacioni i koduar "Route".

Transportonte me automjet, kundrejt pagesës, 6 emigantë nga Sudani që synonin të kalonin ilegalisht kufirin, kapet në flagrancë dhe arrestohet drejtuesi i automjetit.

Sekuestrohen automjeti, 7 celularë dhe një shumë parash.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme të DVP Korçë, si rezultat i punës hetimore të kryer me metoda proaktive, gjatë 3 javëve, në drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, ka oganizuar dhe finalizuar në bashkëpunim me Forcën e Posaçme "Shqiponja", operacionin e koduar "Route".

Në kuadër të operacionit u arrestua shtetasi K. M., 23 vjeç, banues në fshatin Sukth, Durrës, për veprën penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve".

Ky shtetas u kap në flagrancë nga shërbimet e Policisë, mbrëmjen e djeshme, në aksin rrugor "Korçë-Bilisht", në afërsi të fshatit Progër, duke transportuar me automjet, drejt

## Kryesore



**Live/ Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së, Thaçi, Krasniqi, Veseli e Selimi. Të pafajshëm për krime kundër njerëzimit**
11:56

**"Ne jemi napolitanët e anës tjetër", Rama në ceremoninë e hapjes së Konsullatës Shqiptare në Napoli: Kemi hapur një derë mes dy realiteteve të afërta**
08:09

**I akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, Gjykata Supreme e Brazilit pranon ekstradimin e Ervin Matës drejt Shqipërisë**
07:40

**Rrëzohet helikopteri pranë një zone tregtare në Los Angeles, 3 persona humbin jetën**
07:13

**Europa League ngre sot siparin, sytë te Milan-Benfica, Dinamo e Zagrebit e Arbër Hoxhës mat forcat me Hapoel Beer Sheva**
09:48

## Më të lexuarat

**"Daja i deputetes më ka përdhunuar", Zegjine Çaushi reagon pas denoncimit të 34-vjeçares, publikon foton e tyre si çift: Më thanë se do martohen**

**"Kryetari i pagëzuar rishtaz nga Kushtetuesja nuk mund të lëvizë nga qelia"/ Vendimi për Veliajn, Rama: Rast unikal në historinë e Europës demokratike**

**Mbyllet seanca në Hagë/ Gjykata speciale në Hagë dënon me 25 vite burg Hashim Thaçin, 81 vite në total për ish-liderët e UÇK**

**Seanca për ish-krerët e UÇK-së në Hagë, gjykata dënon me 25 vite burg Hashim Thaçin**

**"Po e vendosin njerëzimin në rrugën e shkatërrimit", Rusia sulmon SHBA-në pasi pranoi se ka sisteme armësh në hapësirë**

**"Puna e SPAK, efektive", mesazhe të forta nga zyrtari i DASH, Lawton: Po punojmë me Shqipërinë për të goditur organizatat kriminale transnacionale**

**Rama udhëton drejt SHBA-së në 20 shtator, zbardhen detaje nga takimet që pritet të zhvillojë**

**"U vërtetua arrestimi i paligjshëm i së paku 385 personave"/ Trupi gjykues: Të ndaluarit u rrahën dhe iu shkaktuan vuajtje psikologjike**

Tiranës, kundrejt pagesës 600-700 euro për çdo person, 6 emigrantë nga Sudani, të cilët synonin të kalonin ilegalisht kufirin.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

**Top Channel**

Japonia thyen rekorde, kalon për herë të parë shifrën e 100 mijë persona mbi moshën 100-vjeçare, pjesa më e madhe janë gra

Ish-krerët e UÇK-së lihen në burg, reagon Rama: Marre!

## Aktualitet »



**Shiste kokainë dhe kanabis në lokalin ku punonte si kamerier, arrestohet 18-vjeçari në Elbasan**

16/09 11:40



**Bashkia e Maliqit përballë shkrirjes/ Banorët kundër bashkimit me Korçën: A do t'i shkelë kryetari të gjitha fshatrat?**

16/09 10:53



**Rama në Korçë për Reformën Territoriale, të moshuarit kërkojnë të takojnë kryeministrin: Marrim 10 mijë lekë pension në muaj**

16/09 10:50



**Emërimi i prokurorit Ols Dados përfundon në Apelin Administrativ, hidhet shorti për ankimimin e Veliajt**

16/09 10:17



**Gjendet 7-vjeçari i humbur në Kukës, ribashkohet me familjen**

16/09 10:02



**Banesat pa dokumente pronësie, Kadastra zbret në terren në 23 fshatra të Himarës/ Publikohet kalendari me datat e evidentimit derë më derë**

16/09 09:46

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



**Top Channel/ "Marre", Prishtina në revoltë pas vendimit të Speciales: Poshtë spiunët**



**Top Channel/ Qytetarët që mbetën jashtë takimit të Ramës në Korçë: Vetëm ai na i zgjidh hallet**



**Top Channel/U dënuan me 25 dhe 18 vite burg, ja çfarë shprehën djali i Thaçit e Veselit pas vendimit**




**Top Channel/ BE "sfidon" Trumpin, afron Kanadanë: "Të bëhet anëtarja e parë e asociuar e bllokut"!**



**Top Channel/ Vendimi i Hagës, qytetarët shprehin revoltë në Prishtinë. Dëgjohen krisma armësh**



**Top Channel/ Karburantet në Gjermani çmime rekord, Merz: "Do të ndërhyjë qeveria"!**


Sociale
Video
Top News LIVE
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip
Receta gatimi
Të gjitha programet
Guida TV
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.